



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**U R D H E R**  
**N R. 22 DATË 23. 01. 2006**

**PËR**  
**PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE TË SEKTORIT TË MBIKËQYRJES SË**  
**EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE TRAJTIMIN E TË**  
**DËNUAVE ME BURGIM**

**Me synim,** përcaktimin e funksioneve të Sektorit të Mbikëqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Trajtimin e të Dënuave me Burgim në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, i krijuar me urdhërin nr.4, datë 6.01. 2006;

**Ne mbështetje,** të neneve 8 pika 2, 9 pika 2 e vijues të ligjit nr. 8737 datë 12.02.2001 "Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin Nr. 9102 datë 10. 07. 2003, nenit 463 e vijues të K. Pr. Penale, si dhe të ligjit Nr. 8331 datë 21. 04, 1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" dhe të ligjit Nr. 8328 datë 16. 04. 1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim",

**URDHËROJ:**

1. Sektori i Mbikëqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Trajtitimit të Dënuarve me Burgim ushtron funksionet dhe është përgjegjës:
  - a) për ekzekutimin e vendimeve me ekzekutim të menjëhershëm të Gjykatës së Lartë dhe të masave të sigurimit të urdhëruara prej saj të cilët tërhiqen dhe vihen në dispozicion të kësaj Zyre nga secili prokurorë që përfaqëson çështjen pranë asaj gjykate;
  - b) për të kontrolluar ligjshmërinë dhe efektivitetin në ushtrimin e funksioneve të prokurorëve, në ekzekutimin e vendimeve penale dhe; mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit, në Prokuroritë e të gjithë niveleve, si dhe për ti ndihmuar ata nga ana metodike, duke:
    - kryer kontrole dhe inspektime të plota ose të pjesëshme si sektor" dhe/ose në bashkërendim me Drejtorinë e Personelit dhe Inspektimit të kësaj Zyre, lidhur me zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore për ekzekutimin e vendimeve penale dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve;
    - informuar Prokurorin e Përgjithshëm për shkeljet e evidentuara, si dhe duke propozuar masat që duhen marrë dhe personat përgjegjës.
  - c) për të ndjekur në dinamikë ecurinë e ekzekutimit të vendimeve penale dhe evidentuar periodikisht, çdo 3-muaj, gjendjen në shkallë vendi dhe

sipas Prokurorive, të vendimeve penale të ekzekutuara, në' ekzekutim dhe të paekzekutuara;

- d) për bashkërendimin me drejtorit ose sektorët përkatës në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme dhe/ose me institucione të tjera në këte fushe, duke ju bërë prezent problemet dhe kërkuar prej tyre marrjen e masave për zbatimin e ligjit dhe vënien para përgjegjësisë së personave fajtorë;
- e) për të iniciuar dhe ndjekur trajnimet për ngritjen profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të caktuar për ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit, duke bashkërenduar me Drejtorinë e Studimeve dhe Drejtorinë e Personelit dhe Inspektimit;
- f) për të përgatitur, në bashkërendim me Drejtorinë e Studimeve, projektakte normative, qarkore, studime dhe analiza në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe mbikëqyrjes së vuajtjes së dënimit;
- g) për ti dhënë zgjidhje ligjore ankesave dhe kërkesave, që vijnë në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit.

2. Prokurori - shëf i këtij Sektori dhe oficeri i policisë gjyqësore i kësj strukture kryejnë dhe funksione të tjera të caktuara me ligj ose me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Për zbatimin dhe për të ndjekur e kontrolluar zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen personeli i Sektorit të Mbikëqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Trajtimit të Dënuarve me Burgim i kësj Zyre, si dhe prokurorët dhe drejtuesit e prokurorive të të gjithë niveleve.

4. Mospërmbushja e detyrave të përcaktuara në këte urdhër, përbën shkelje të disiplinës në punë.

5. Urdhërat dhe çdo akt tjetër normativ i kesaj Zyre që bie në kundërshtim me këte urdhër, shfuqizohen.

6. Me këte urdhër të njihen prokurorët dhe drejtuesit e Prokurive të të gjithë niveleve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PERGJITHSHEM**

**THEODHORI SOLLAKU**